



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.320/2 prot.,

Datë 12.02.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK në procedurën e prokurimit “*Proçedurë e Hapur e thjeshtuar – Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm fitues për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)*” me Nr. REF-91668-12-19-2023, me objekt: loti 1: “*Blerje materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja te Spitalit Rajonal Vlore*” me fond limit 17,754,400 Lekë, pa TVSH ose 173,129.2 ( *Njeqind e shtedhjete e tre mije e njeqind e njezete e nente pike dy* ) EURO pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 19.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.

**Ankimues:**

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Montal” SHPK, me NIPT: J62009007F & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK me NIPT: J61827062E.  
Adresa: *DERVISH HIMA-3KULLAT K.3 AP9/2, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:**

Spitali Rajonal Vlorë.  
Adresa: *Lagja “Partizani”, Vlorë*

Në datën 09.02.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/3795 dhe me nr. 320 protokollit datë 09.02.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e thjeshtuar – Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm fitues për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)*” me Nr. REF-91668-12-19-2023, me objekt: *loti 1: “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë” me fond limit 17,754,400 Lekë, pa TVSH ose 173,129.2 ( Njëqind e shtedhjetë e tre mijë e njëqind e njetë e nente pike dy ) EURO pa TVSH* parashikuar për tu zhvilluar në datën 19.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

*b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.*

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që bashkimi i operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 320 prot., datë 09.02.2024.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

#### **Arsyet e skualifikimit:**

*BOE Montal shpk dhe Biometric Albania ,shpk kane paraqitur ne sistemin elektronik certifikatat Iso, certifikatate konformiteti CE, si dhe autorizim prodhuesi ne gjuhe te huaj(anglisht dhe italisht) dhe jo ne Gjuhen shqipe,pervec dokumentave te kompanise prodhuese “STORZ” qe jane te perkthyer dhe te noterizuara me nr rep 199/200 dt 13.01.2024.Mbeshtetur ne ligjin e prokurimit publik Neni 74’’ dokumentat e tenderit’’ pika 1 citoheT’’Autoriteti ose enti kontraktor, ne hartimin e dokumentave te tenderit,perdor dokumenta standarte,sipas percaktimit ne rregullat e prokurimit publik dhe i ve ne dispozicion falas ne rruge elektronike.Ne dokumentat standarte te kesaj procedure dhe pikerisht ne formularin e kriterëve te perzgjedhjes si dhe ne kriteret e vecanta te kualifikimit pikat 4,5,6,eshte cilesuar qe dokumentat duhen te jene te perkthyer ne Gjuhen Shqipe dhe te noterizuara..*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 12.02.2024.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar  
Fiorent Zguro**

**Anëtar  
Anila Malaj**

**Anëtar  
Kreshnik Ternova**

**Kryetar  
Jonaid Myzyri**